



Kriteret për Akreditimin e Aktiviteteve të të Mësuarit në Distançë

Nëntor 2010

PUNUAN:
Kristina Voko
Amarda Cenko

© Të drejtat e këtij botimi i përkasin Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim.

Për kopje elektronike të këtij botimi vizitoni faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim www.qkev.gov.al.

Ky botim është mbështetur nga projekti “**Sistemi për Zhvillim Profesional**”, me fondet e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Albania
Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri

LENDA

I – HYRJE.....	3
A – Qëllimi i Dokumentit	4
B – Koncepte Bazë.....	4
II – AKTIVITETET E TË TË MËSUARIT	
NË DISTANCË DHE KREDITET PËRKATËSE.....	6
III– KRITERET E VLERËSIMIT	
TË BRENDSHËM DHE TË JASHTËM.....	8
A – Qëllimi dhe Objektivat	8
B – Përmbajtja e materialit	9
C – Vlerësimi dhe Përmirësim	12

I – HYRJE

Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim (QKEV) është një institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ka për qëllim nxitjen dhe zhvillimin profesional të të gjitha kategorive të personelit të shëndetësisë, me synim rritjen e njohurive dhe zhvillimin e aftësive të tyre, në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Një ndër detyrat e QKEV-së është realizimi i procesit të akreditimit të programeve dhe veprimtarive të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë. Në këtë kuadër, QKEV-ja ka hartuar gjatë vitit 2009 kuadrin rregullator për akreditimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim, i cili është miratuar nga Ministria e Shëndetësisë në Korrik 2009.

Në dokumentin e mësipërm janë përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të përfshirë në sistemin e edukimit në vazhdim, procedurat e akreditimit, si dhe kriteret bazë të cilësisë që duhet të përmbushin aktivitetet e drejtpërdrejta të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë.

Gjatë viteve të fundit, falë zhvillimeve të teknologjisë dhe rritjes në masë të përdorimit të kompjuterit dhe mjeteve të tjera elektronike, janë përhapur dhe forma të reja të edukimit në vazhdim, të ndryshme nga ato tradicionale. Gjithnjë e më tepër, institucionet akademike dhe ato të edukimit në vazhdim në botë po zhvillojnë programe të edukimit në distancë. Në Shqipëri gjithashtu lind e nevojshme hartimi i kriterëve të cilësisë për akreditimin e aktiviteteve të të mësuarit në distancë, me qëllim që të orientojë dhe rregullojë vënien në zbatim të programeve të tilla bazuar në kriterë të përcaktuara të akreditimit.

Aktivitetet e të mësuarit në distancë, jo vetëm zgjerojnë gamën e aktiviteteve në të cilat mund të përfshihen profesionistët e shëndetësisë drejt zhvillimit të tyre profesional dhe plotësimit të kërkesave të programit të ricertifikimit, por për më shumë, ofrojnë disa përparësi, si:

- mundësia e përfshirjes në to e një numri të pakufizuar profesionistësh ose i profesionistëve nga zona të largëta; dhe
- liria që ka profesionisti të ndjekë këto aktivitete në kohën dhe vendin më të përshtatshëm për të.

A – Qëllimi i Dokumentit

Ky dokument ka për qëllim të ofrojë një kuadër rregullator për përkufizimin e aktiviteteve të të mësuarit në distancë për profesionistët e shëndetësisë, si dhe kriteret e cilësisë që këto aktivitete duhet të përmbushin në kuadër të procesit të akreditimit.

Rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të përfshirë në procesin e akreditimit, si dhe procedurat që lidhen me të, janë të njëjta me ato të aktiviteteve të drejtpërdrejta të edukimit në vazhdim, të përshkruara në Dokumentin Rregullator.

Në këtë dokument, me aktivitete të të mësuarit në distancë do të nënkuptojmë të gjitha ato aktivitete të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë të cilat ofrohen përmes: incizimeve audio dhe/ose video, materialeve të regjistruara në Compact Disc ose Digital Versatile Disc (DVD), të ofruara on-line përmes një faqeje interneti edukative, materialeve të printuara, ose një përzierje e të gjithë metodave të mësipërme. Kjo listë nuk mund të konsiderohet gjithëpërfshirëse.

Ky dokument nuk mbulon akreditimin e të gjithë aktiviteteve “live” të edukimit në vazhdim, si dhe materialet on-line që mund të shpërndahen për të mbështetur këto aktivitete.

B – Koncepte bazë mbi të mësuarin në distancë

Të mësuarit në distancë është procesi ose sistemi mësimor që realizohet përmes mjeteve të komunikimit elektronik ose materialeve të shtypura (printuara) për profesionistët e shëndetësisë si në kohë reale ashtu dhe në kohë të ndryshme, dhe në distancë nga burimi edukativ dhe nga njëri-tjetri.

Aktivite të të mësuarit në distancë janë të gjitha aktivitetet që synojnë të përmbushin nevojat e profesionistëve të shëndetësisë, duke iu ofruar mundësinë të zgjedhin kohën, vendin dhe mënyrën më të përshtatshme për të mësuar, pa qenë të pranishëm fizikisht në një klasë ose mjedis tradicional mësimi.

Ofrues të aktiviteve të të mësuarit në distancë janë të gjitha institucionet, fitimprurëse ose jo fitimprurëse, që janë përgjegjës për shpërndarjen e materialit didaktik, si dhe për monitorimin dhe vlerësimin e pjesëmarrjes në aktivitet nga ana e profesionistëve të shëndetësisë. Ky institucion mund të jetë i njëjtë ose i ndryshëm nga institucioni përgjegjës për zhvillimin e materialit didaktik. Nga procesi i vlerësimit dhe akreditimit përjashtohen të gjitha ato institucione të cilat prodhojnë ose tregojnë mallra, të cilat përdoren te ose nga pacientët, të cilat konsiderohen si palë të interesit komercial. Këto të fundit mund të mbështesin financiarisht aktivite të edukimit në vazhdim, në përputhje me politikat e parashikuara nga institucioni akreditues për mbështetjen financiare dhe konfliktin e interesit, por jo të ofrojnë aktivite të akredituara në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Material didaktik do të quhet i gjithë informacioni i dallueshëm nga pjesëmarrësi në aktivitetin e të mësuarit në distancë, qoftë përmes faqes së internetit, CD-së ose DVD-së, ose materialeve të printuara.

II – AKTIVITETET E TË MËSUARIT NË DISTANCË DHE KREDITET PËRKATËSE

Aktivitetet e të mësuarit në distancë janë ato aktivitete që synojnë të përmbushin nevojat e profesionistëve të shëndetësisë, duke iu ofruar mundësinë të zgjedhin kohën, vendin dhe mënyrën më të përshtatshme për të mësuar, pa qenë të pranishëm fizikisht në një klasë ose mjedis tradicional mësimi.

Lloji i aktivitetit në distancë përcaktohet kryesisht nga mjeti i teknologjisë së përdorur. Disa nga llojet më të hasura të aktiviteteve të edukimit në distancë janë:

Aktivitete të të mësuarit në distancë të bazuara në materiale të printuara

– Në këto lloj aktiviteteesh përdoren materiale të printuara si burimi kryesor i informacionit edukues, në mënyrë të veçantë për pjesën e vetë-studimit. Këto materiale mund të përfshijnë module, manuale trajnimi me ushtrime dhe teste, dhe libra.

Aktivitete të të mësuarit në distancë të bazuara në përdorimin e kompjuterit

– Në këto aktivitete, kompjuteri është burimi kryesor i përdorimit të materialit didaktik, i cili mund të shpërndahet përmes CD-ROM; USB; DVD, ose programe software.

Aktivitete të të mësuarit në distancë të bazuara në përdorimin e internetit

– Në këto aktivitete materiali didaktik shpërndahet përmes faqeve didaktike të internetit. Ky grup përfshijnë dhe aktivitetet sinkrone, si grupe trajnimi virtuale, komunikime me shkrim në kohë reale (chat), dhe web-konferencat audio/video, dhe aktivitete asinkrone, si e-mail, programe interneti ndëraktive, dhe shkarkimi i materialeve audio ose video.

Përlllogaritja e krediteve për aktivitetet e të mësuarit në distancë kryhet sipas kriterit një orë – një kredit, bazuar vetëm në orët efektive. Orët

efektive përlogariten bazuar në orët që i nevojiten mesatarisht një pjesëmarrësi për të përmbushur objektivat mësimorë të aktivitetit, përmes kohës së parashikuar për shqyrtimin e materialit didaktik, por dhe kohës së nevojshme për zgjidhjen e ushtrimeve ose testeve që e shoqërojnë atë.

III– KRITERET E VLERËSIMIT TË BRENDSHËM DHE TË JASHTËM

Në këtë kapitull përmbledhen kriteret bazë të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të aktiviteteve të të mësuarit në distancë, të cilat duhet të demonstrohen nga ofruesi në dosjen e tij të vlerësimit. Këto kritere duhet të deklarohen me vërtetësi, bazuar në vullnetin e lirë të aplikuesit.

A – Qëllimi dhe Objektivat

Kriteri 1. Ofruesi duhet të tregojë procesin e ndjekur për vlerësimin e nevojave edukative të profesionistëve që planifikohet të marrin pjesë në aktivitet, si dhe të deklarojë nevojat e identifikuara të cilat do të plotësohen përmes aktivitetit të propozuar.

Kriteri 2. Ofruesi duhet të paraqesë një deklaratë të qëllimit të aktivitetit, e cila të tregojë se aktiviteti është planifikuar me qëllim përmbushjen e nevojave edukative të deklaruara, si dhe të demonstrojë se si do të arrihet kjo.

Kriteri 3. Ofruesi duhet të deklarojë rezultatet edukativë të pritshëm të aktivitetit. Këto rezultate duhet të shprehen në formën e objektivave të lidhur me njohuritë, shprehitë ose qendrimet, të cilat do të fitohen nga pjesëmarrësi, qoftë këto të lidhur me kontekstin klinik ose jo.

Kriteri 4. Ofruesi duhet të përdorë një sërë përqasjesh të hartuara për të përmbushur nevojat e pjesëmarrësve me stile të ndryshëm të të mësuarit. Gjatë hartimit të kursit duhet të parashikohet që pjesëmarrësi:

- Të reflektojë, të rishikojë dhe të asimilojë njohuritë e reja.
- Të aplikojë njohuritë e marra dhe të praktikojë aftësi të reja.

- Të vlerësojë ecurinë e tij.

Kriteri 5. Ofruesi duhet të deklarojë grupin kryesor të profesionistëve për të cilën materiali do të ishte më i përshtatshëm. Ky grup duhet të specifikohet përmes profesionit, specialitetit ose nivelit të eksperiencës së pjesëmarrësve në fushën përkatëse.

Kriteri 6. Ofruesi duhet të deklarojë kohëzgjatjen në orë të kohës që pjesëmarrësit do i duhet për të përmbushur objektivat edukativë të aktivitetit.

Kriteri 7. Ofruesi duhet të deklarojë datën e zhvillimit (hartimit) të materialit, çdo rishikim të mundshëm të tij, si dhe kohëzgjatjen e vlefshmërisë së tij.

Kriteri 8. Ofruesi duhet të deklarojë formatin e nevojshëm për përdorimin e materialit (p.sh. Windows/MacOS; lexues DVD), si dhe duhet të ofrojë detaje mbi kontaktet për ofrim mbështetjeje (teknike) për pjesëmarrësit, në rastin e aktiviteteve që përdorin teknologjinë e informacionit.

B – Përmbajtja e materialit

Kriteri 9. Ofruesi duhet të paraqesë një përmbledhje të përmbajtjes së materialit. Kjo përmbledhje prezantuese e aktivitetit u duhet bërë e ditur dhe pjesëmarrësve përpara se ata të regjistrohen në aktivitet dhe duhet të përmbajë të paktën pikat e mëposhtme:

- Qëllimin e kursit
- Objektivat edukativë
- Strukturën e kursit

- Periudhën e vlerësuar kohore të studimit (orët efektive)
- Periudhën kohore të nevojshme për plotësimin e të gjithë kursit
- Çdo material (libër, software, etj) që nevojitet të ketë pjesëmarrësi
- Hardwarin dhe softwarin që nevojitet për të përdorur materialet
- Instruksione për përfitimin optimal nga kursi

Kriteri 10. Ofruesi duhet të respektojë dhe të konfirmojë konfidencialitetin e pjesëmarrësit, si dhe të konfirmojë faktin që çdo informacion mbi pjesëmarrësit në aktivitet do të përdoret vetëm për qëllimet specifike të përmbushjes së kërkesave të këtij materiali. Rastet e vetme të përjashtimit duhet të jenë me informimin dhe miratimin e plotë të pjesëmarrësit.

Kriteri 11. Ofruesi duhet të paraqesë përputhjen e materialit me të gjithë kërkesat etike, mjeko-ligjore dhe ligjore përkatëse. Në rastet kur përdoren informacione personale, ofruesi duhet të ofrojë miratimin mbi konfidencialitetin nga pacientët ose pjesëmarrësit e tjerë, informacioni ose fotografitë e të cilëve janë përfshirë në këtë material; respektimin e kërkesave etike mbi kërkimet e përdorura; përmbushjen e kërkesave të ligjit mbi mbrojtjen e të dhënave; të dhëna mbi të drejtat e autorit të informacioneve të përfshira në material.

Kriteri 12. Të gjitha informacionet e ofruar në brendësi të materialit duhet të jenë të bazuar në të dhëna, me shënime mbi natyrën ose shkallën e efikasitetit (kur është e aplikueshme), dhe referencat përkatëse. Në lidhje më sa më sipër duhet të zbatohen rregullat e shkrimit akademik të aplikuara për publikimet në revistat shkencore.

Kriteri 13. Materiali i përdorur duhet të nxisë pjesëmarrësin drejt përdorimit të metodave andragogjike dhe ndëraktive për përmbushjen e objektivave edukativë. Këto metoda mund të përfshijnë: të mësuarit

e orientuar drejt zgjidhjes së problemit, të mësuarit bazuar në detyra praktike, të mësuarit bazuar në studime rasti, të mësuarit reflektiv dhe përmirësimin të performancës. Ofruesi duhet të nxisë ndërveprimin përgjatë të gjithë kursit përmes komunikimit mes pjesëmarrësve ose/ dhe tutorëve.

Kriteri 14. E gjithë përmbajtja e materialit duhet të jetë e pastër nga çdo formë interesi komercial ose promocional. Kur ofrohen të dhëna të vlefshme mbi përparësitë e një trajtimi ose produkti (në terma xhenerikë), kjo duhet të deklarohet dhe të mbështetet me referenca sipas kriterëve të një botimi shkencor.

Kriteri 15. Materiali duhet të jetë i strukturuar në seksione logjike dhe të organizuara në mënyrë të tillë që të lehtësojnë të nxënit.

Kriteri 16. E gjithë përmbajtja e materialit duhet të jetë shkruar në mënyrë të përshtatshme për grupin e pjesëmarrësve të cilëve u drejtohet; të jetë i pastër nga materiale diskriminuese mbi racën, seksin ose moshën; të jetë i qartë dhe pa gabime gramatikore ose drejtshkrimore.

Kriteri 17. E gjithë përmbajtja e materialit duhet të mos përmbajë asnjë formë reklame ose promovimi për një produkt ose shërbim specifik.

Kriteri 18. E gjithë përmbajtja e materialit duhet të jetë e lehtë për t'u përdorur (user-friendly).

Kriteri 19. Ofruesi duhet të deklarojë me shkrim një përshkrim të shkurtër të institucionit ofrues. Në material lejohet përdorimi i logos së institucionit ofrues, por jo përdorimi i saj për çfarëdolloj reklame ose promovimi.

Kriteri 20. Materiali duhet të deklarojë në mënyrë të qartë dhe me shkrim, emrat dhe kualifikimet e personave të përfshirë në hartimin e tij.

Kriteri 21. Duhet të ofrohet një deklaratë e plotë e konflikteve të

mundshme të interesit të personave të përfshirë në përgatitjen e materialeve. Fitimet monetare nga shitja ose marketingu i materialit në vetvete nuk do të konsiderohet si një konflikt interesi.

Kriteri 22. Burimi i të gjitha mbështetjeve financiare për hartimin e materialit duhet të deklarohet me shkrim.

Kriteri 23. Materiali duhet të ofrojë emrin dhe titullin e një profesionisti të shëndetësisë, i cili do të konsiderohet përgjegjës për përmbajtjen e materialit. Materiali duhet të përmbajë dhe kontaktet e këtij profesionisti.

Kriteri 24. Materiali duhet të përmbajë “hot-links” për informacion të mëtejshëm, por asnjë nga këto faqe nuk duhet të përmbajë informacion komercial ose promovues.

Kriteri 25. Ofruesi nxitet që të ofrojë mbështetje teknike për pjesëmarrësin në lidhje me ndjekjen e aktivitetit.

C – Vlerësimi dhe Përmirësimi

Kriteri 26. Materiali duhet të përfshijë një mënyrë për konfirmimin e përfshirjes së pjesëmarrësit, si dhe të përmbushjes së objektivave edukativë. Cilësia, kohëzgjatja dhe përmbajtja e tyre duhet të jetë e përshtatshme për materialin dhe objektivat e tij edukativë, dhe duhet të prezantohet si pjesë përbërëse e materialit.

Kriteri 27. Vlerësimi duhet të bazohet në pyetësorë me zgjedhje të shumëfishtë (multiple-choice) ose metoda të tjera vetë-vlerësimi, por duhet të përmbajë kritere të qarta vlerësimi (p.sh. përqindja kaluese). Forma e vlerësimit duhet të hartohet nga ofruesi i përmbajtjes edukative (që në disa raste mund të jetë i ndryshëm nga ofruesi i produktit).

Kriteri 28. Ofruesi duhet të lëshojë certifikata/dëshmi për pjesëmarrësit në aktivitet, të cilat duhet të përmbajnë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- Titullin e aktivitetit, ashtu siç është deklaruar në dosjen e vlerësimit të brendshëm;
- Institucionin ofrues të aktivitetit;
- Datën dhe vendin e zhvillimit të aktivitetit;
- Mbishkrimin “Ky aktivitet është i akredituar nga QKEV dhe i njihen ... kredite” me numrin përkatës të krediteve për secilin pjesëmarrës.

Kriteri 29. Ofruesi duhet të sigurojë një mënyrë të besueshme dhe efikase për pjesëmarrësit, në mënyrë që ata të ofrojnë sugjerime për materialin, si dhe është i detyruar që të ofrojë një raport përmbledhës pranë QKEV-së të këtyre sugjerimeve dhe përgjigjes ndaj tyre.

Kriteri 30. Të dhënat mbi vlerësimin e ofruesit mbi programet e kaluara ose ato në vazhdimësi duhet të jenë pozitive, ose në të kundërt arsyet për vlerësimin jo-pozitiv duhet të jenë adresuar në aktivitetin e propozuar.

Kriteri 31. Procesi i planifikimit, zhvillimit dhe vlerësimit të një aktiviteti të të mësuarit në distancë duhet të respektojë të gjitha kriteret mbi mbështetjen komerciale dhe konfliktin e interesit të specifikuara në Kapitullin V të Dokumentit Rregullator për Akreditimin e Aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim për profesionistët e shëndetësisë.

